



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:011641
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05728760

KPPP.nr.1591/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbarimore të kreditorit “ELEKTRO GG” Sh.P.K., me NUI:810873134, me seli në Prishtinë, Rr.”Vushtrisë” nr.5, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Hasan Rexha avokat nga Prishtina Rr.”UÇK”, nr.101/5, kundër debitorit “FSF” SH.P.K., me NUI:810829004, me seli në Prishtinë, Rr.”Pashko Vasa” nr.2-1, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.574/21 të datës 28.12.2021, të Përmbaruesit Privat Kushtrim Metaj nga Prishtina, jashtë seancës, me datë 23.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “FSF” SH.P.K., me NUI:810829004, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.574/21 i datës 28.12.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Kushtrim Metaj.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.574/21 i datës 28.12.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Kushtrim Metaj.
- III. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, Urdhërohet që në afatin prej 7 (shtatë) ditësh të paguaj garancinë në shumë prej 807.54 €.
- IV. Nëse debitori dështon të paguaj shumën e garancisë brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

V. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin propozimit për përmbarrim t'ia paguaj kreditorit shumën prej 104.00 € (njëqind e katër euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përmbarruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit "ELEKTRO GG" Sh.P.K., me NUI:810873134, ka lëshuar urdhrin përmbarrimor P.nr.574/21 të datës 28.12.2021, me të cilin ka lejuar përmbarrimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht fatura me numër 20-SHV01-002-3263 e datës 24.11.2020, fatura me numër 20-SHV01-002-3274 e datës 24.11.2020, fatura me numër 20-SHV01-002-3317 e datës 27.11.2020, fatura me numër 20-SHV01-002-3325 e datës 27.11.2020, fatura me numër 20-SHV01-002-3360 e datës 01.12.2020, fatura me numër 20-SHV01-002-3372 e datës 01.12.2020 dhe fatura me numër 20-SHV01-002-3384 e datës 02.12.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që t'ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të mbetur sipas faturave të lartcekura në shumë prej 807.54 €, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e arritjes për pagesë, shumën prej 104 euro në emër të përpilimit të propozimit dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare, regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor, ndër të tjerash ka theksuar se faturat nuk janë të nënshkruara nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të debitorit dhe nuk janë të vulosura nga ana e debitorit, dhe se në certifikatën dhe informatat e biznesit të debitorit janë të listuar 4 pronarët dhe drejtori i kompanisë i cili është person i autorizuar. Ka shtuar se faturat e lëshuara nga ana e kreditorit nuk kanë efekt juridik dhe çdo pretendim i kreditorit duhet të iniciohet në procedurë kontestimore për faktin që malli i ofruar nga kreditori nuk ka pasur kualitetin e kërkuar nga debitori dhe për faktin që do të argumentohen në vijim, nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që të aprovoj prapësimin si të bazuar, të anulohet urdhri përmbarrimor, si dhe të detyrohet kreditori t'ia kompensoj shpenzimet procedurale.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, i ka kundërshtuar pretendimet si të pa bazuara, ndër të tjerash ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet se faturat nuk janë pranuar nga personat përgjegjës të debitorit, të njëjtat janë vetëm tentim për t'iu

shmangur detyrimin ndaj kreditorit, i njëjti e ka pranuar mallin dhe faturat me rregull, i ka nënshkruar dhe të njëjtat asnjëherë nuk i ka kundërshtuar. E për më tepër me vet deklarinimin në prapësim se mallrat e ofruara kinse nuk i përmbajnë kualitetet e dakorduara është tregues i qartë se debitori i ka pranuar si mallrat ashtu edhe faturat me rregull. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit, të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, shqyrtimit të përgjigjes në prapësim dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura me numër 20-SHV01-002-3263 e datës 24.11.2020, fatura me numër 20-SHV01-002-3274 e datës 24.11.2020, fatura me numër 20-SHV01-002-3317 e datës 27.11.2020, fatura me numër 20-SHV01-002-3325 e datës 27.11.2020, fatura me numër 20-SHV01-002-3360 e datës 01.12.2020, fatura me numër 20-SHV01-002-3372 e datës 01.12.2020 dhe fatura me numër 20-SHV01-002-3384 e datës 02.12.2020, në bazë të cilave është lejuar urdhri për përmbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm respektivisht faturat e lartcekura i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par.3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët,

përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave, dhe është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Në rastin konkret rezulton se faturat janë dorëzuar në original nga ana e kreditorit dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, gjë e cila vërtetohet edhe nga nënshkrimi i debitorit si dhe fakti që faturat nuk janë kontestuar asnjëherë nga ana e debitorit, e për më tepër një pjesë e borxhit nga të njëjtat është paguar.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim, mirpo erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin tjera të paraqitura nga debitori, sepse të njëjtat pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohe vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbarimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, Gjykata lidhur me këtë çështje përmbarimore, vlerëson se urdhri për përmbarim i lejuar mbi bazën e dokumentit të besueshëm nuk është në kundërshtim me dispozitën e nenit 29 të LPP-së, ngase nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit siç përcaktohet në nenin 71 të LPP-së.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin, në rast se parashtrohet ankesë kundër këtij aktvendimi, në afatin prej 7 ditëve, në momentin e parashtrimit të ankesës të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar nga gjykata si në pikën III, të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoj provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për procedurën përmbarimore dhe atë në shumën prej 104.00 € në emër të përpilimit të propozimit për përmbarim, siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1591/22, datë 23.05.2024

Gjyqtari

Gent Bkeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.